



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

RELACION

Relacion mbi shtesë fondesh ne buxhetin e bashkisë, për projektin “Qëndrojmë së Bashku”.

Të nderuar Këshilltarë ,

Bashkia Berat është përfituese e projektit “Qëndrojmë së Bashku”, financuar nga UNDP, sipas Marrëveshjes Nr. 3270/3 date 26.06.2023.

Qëllimi i këtij projekti është të rrisë kapacitetet e shërbimit social në Bashkinë Berat për të ofruar mundësi më të mëdha dhe më të afërta shërbimi ndaj individëve dhe familjeve në nevojë, si grupe vulnerabël, gra dhe viktime të dhunës në familje si dhe fëmijëve në situatë rruge dhe në vështirësi social dhe ekonomike. Ky projekt parashikon ngritjen dhe funksionimin e një skuadre terreni e cila aktualisht i mundon Bashkisë Berat. Kjo skuadër terreni do të ketë tre funksione kryesore: 1) Dhënien e mbështetjes për strukturat e shërbimit social në Bashkinë Berat 2) ofrimi i shërbimit në familje ndaj individëve, personave të vetmuar, 3) krijimit të rrjetit të vullnetarizmit në sektorin e shërbimit social në Bashkinë Berat.

Ky projekt është fituar në vitin 2023 dhe në kuadër të tij është e nevojshme që të miratohet shtesë në të ardhurat e Bashkisë Berat nga PNUD për projektin “Të Qëndrojmë së Bashku” në shumën 2,226,590 lekë. Këto të ardhura do të përdoren për zbatimin e projektit.

Kërkojmë nga ana juaj miratimin e shtesës së fondeve në të ardhurat e bashkisë në shumën 2,226,590 lekë.

DREJTORE E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PROJEKTEVE

Etleva Dhima

DREJTORE E FINANCË BUXHETIT

Rovena Shehu